

**Takim pune i ekipit menaxhues të projektit në kuadër të Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) për “zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë”**

Procesverbali i mbledhjes

**Ref. 7/2012**

**Vendi:** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

**Data:** 26 Qershor 2012

**Koha:** 11:00 – 12:00

**Pjesëmarrësit:**

**Robert Wright**, *Shef Kryesor Ekzekutiv, RBKO (kryesues);*  
**Gjylfidane Kadrijaj**, *Drejtoare e Departamentit të Sistemit të Pagesave, BQK;*  
**Zana Haxha**, *Drejtoare e Përgjithshme në SHBK;*  
**Boryana Ivanova Mustafa**, *Drejtoare e Pagesave dhe Thesarit, NLB ;*  
**Akile Cernobregu**, *Drejtoare e Departamentit të Pagesave, PCB;*  
**Teuta Kotorri**, *PCB;*  
**Ozenc Alkan Asik**, *Udhëheqëse e Operacioneve Bankare, TEB;*  
**Edmond Jashari**, *TEB;*  
**Makfire Osmani**, *“KUR” Prishtina;*  
**Blerta Krasniqi**, *PCB;*  
**Erik Roka**, *RBKO;*  
**Fitnete Bekolli**, *KEK;*  
**Hikmete Mataj**, *KEK;*  
**Besian Demiri**, *TEB;*  
**Arzen Çavdarbasha**, *BQK;*  
**Masar Baxhaku**, *BQK;*

Munguan:

**Përfaqësuesit e MF/Thesari, ATK-së, PTK-së dhe MPMS-së**, munguan pa njoftim paraprak .

Takimi filloi në ora 11:00.

Znj. Gjylfidane Kadrijaj hapi takimin, përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje dhe njoftoi për mungesën e një pjese të anëtarëve të grupit, njoftoi të pranishmit me agjendën e takimit.

**Diskutimet dhe prezantimet**

- **Miratimi i procesit dhe konkluzioneve të takimit të fundit**

Z. Robert Wright njoftoi të pranishmit për konkluzionet e takimit të fundit të datës 30.01.2012 dhe nga anëtarët u miratua njëzëri procesverbali i takimit paraprak.

- **Informim lidhur me VISA dhe MASTERCARD**

Z. Wright njoftoi të pranishmit për përgjigjen pozitive nga ana e VISA-së lidhur me ndarjen e një fondi prej 10 000 US\$ për vitin e ardhshëm për financim të kampanjës edukative përmes një “web faqeje edukative”.

Edhe MASTERCARD është shprehur e gatshme për bashkëpunim, dhe njëkohësisht ka kërkuar të dhëna statistikore për instrumentet e pagesave në mënyrë që të kenë një pasqyrë më të çartë për situatën aktuale të pagesave në Kosovë. Besojmë që vitin e ardhshëm edhe MasterCard do të ndaj një fond për të përkrahur zhvillimin e kampanjave vetëdijësuese për përdorimin e instrumenteve të pagesave për qytetarët e Kosovës.

- **Instrumentet dhe terminalët e pagesave - Kosova në krahasim me shtetet në Evropën Qendrore dhe Juglindore (të dhënat e publikuara deri më 20 Qershor 2012)**

Znj. Gjylfidane Kadrijaj prezantoi të dhënat statistikore për terminalët dhe instrumentet e pagesave për Kosovën dhe vendet tjera në rajon. Gjithashtu të pranishmit u njoftuan për vështirësitë e sigurimit të këtyre të dhëna për shkak se shumë banka publikimin e tyre e bëjnë pas muajit Shtator.

Nga të dhënat e prezantuara, u konstatua rritje e shpejt e numrit të terminaleve dhe instrumenteve të pagesave në Kosovë. Krahasuar me vendet në rajon, Kosova ka rritjen më të shpejt gjatë viteve të fundit por akoma mbetet e parafundit e në disa raste edhe e fundit në këtë drejtim. Me një trend të tillë të rritjes dhe me një angazhim të shtuar të të gjithë komunitetit financiar në vend, Kosova gjatë viteve të ardhshme do të jetë afër mesatares së vendeve në rajon.

Nga Znj. Akile Cernobregu dhe të pranishmit u tha që Maqedonia të merret si shembull krahasimi, pasi që niveli i zhvillimit ekonomik dhe treguesit tjerë janë më të afërt me këtë vend.

Lidhur me krijimin e një qendre kombëtare e iniciuar gjatë diskutimeve nga ana e BQK-së dhe e paraparë si e tillë në kuadër të strategjisë, për procesimin e transaksioneve me kartela, Z. Erik Roka (RBKO) tha që krijimi i kësaj qendre do të ndikonte në uljen e kostos së tërheqjeve në ATM me kartelë të një banke në ATM-at e bankave tjera. Znj. Alkan Asik (TEB) njoftoi për marrëveshjet që kanë disa banka mes veti në Turqi, ku në rast se klientët tërheqin në ATM-at e këtyre bankave, ata nuk do të paguajnë shpenzime shtesë. Znj. Akile Cernobregu (PCB) tha që krijimi i kësaj qendre për procesim të transaksioneve me kartela po ashtu do të ndikonte në uljen e kostos së bankave për servisimin e këtyre terminaleve të pagesave (veçanërisht kostoja e transportimit të mjeteve për furnizim të ATM-ve). Z. Robert Wright (RBKO) tha gjithashtu se me krijimin e qendrës procesuese ndoshta bankat do të humbin provizionin që aktualisht marrin nga klientët për përdorimin e tyre por do të përfitojnë nga ulja e kostove të tjera të lidhura me transaksionet e kryera nëpër degë.

- **Informim rreth aktivitetit të nën-grupit punues, përfshirë aktivitetin e DSP/BQK-së në këtë drejtim**

Në emër të nën-grupit punues, *Znj. Boryana Ivanova-Mustafa* bëri një përmbledhje të aktiviteteve të këtij nëngrupi. Gjithashtu njoftoi edhe për takimet e shumta që kanë pasur me kompani të ndryshme.

Lidhur me unifikimin e faturës, u tha që fillimisht ajo planifikohet të përdoret nga kompanitë publike, e më pas edhe nga ana e kompanive tjera.

Sa i përket skemës dhe instrumentit të Debitimit Direkt, BQK-ja ka bërë përshtatjen e rregullativës sipas kërkesës së SHBK-së që autorizimet të nënshkruhen në banka dhe njëkohësisht ka bërë përshtatje teknike të sistemit për implementim.

- **Konkluzione**

1. Takimi i Këshillit Kombëtar të Pagesave u propozua që të mbahet në fund të Korrikut;
2. Nëngrupi punues të vazhdojë punën me KEK-un (dhe kompanitë tjera) lidhur me “web service” dhe autorizimin për Debitim Direkt;
3. Të përgatiten të dhënat statistikore për numër të transaksioneve për tri vitet e fundit;
4. VISA të ftohet në takim përgatitor lidhur me mënyrën e implementimit të projektit për vitin 2013;
5. Të vazhdon komunikimi me MasterCard dhe të ftohet në një takim gjatë këtij viti.